



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Udhëheqës i Njesisë për Auditim të Brendshëm
Klasa e pozitës	Drejtues i Ulët 1
Koeficienti/Paga	2-4
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	05/09/2022
Afati për aplikim	20/09/2022 - 27/09/2022
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit
Departamenti	Njësia e Auditimit të Brendshëm
Divizioni	
Vendi i punës	
Nr. i Referencës	RN00009873
Kodi	RPC0003595



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Auditimet e Brendshme

- Udhëheq, mbikëqyr dhe në përgjithësi, do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet menaxheriale që kanë të bëjnë me njësinë e auditimit të brendshëm;
- Zhvillon planet strategjike dhe auditimet vjetore të organizatës, e po ashtu edhe programet e auditimit, dhe kryen sipas kërkesës planifikimin e auditimit të caktuar;
- Udhëheq dhe mbikëqyr auditimet e brendshme dhe hulumtimet paraprake në përputhje me objektivat e AKP-së, dhe në përputhje me Statutin e Auditorëve të Brendshëm;
- Udhëheq dhe mbikëqyr rishqyrtimet për shfrytëzim sa më efektiv të burimeve të AKP-së, duke i bërë rekomandime të duhura bordit dhe menaxhmentit;
- Organizon dhe monitoron auditimet e brendshme të zyrave regjionale të AKP-së dhe NSH-ve;
- Mbikëqyr dhe udhëheq zhvillimin e auditimit të brendshëm dhe raporteve të tjera, implementimin e rekomandimeve dhe raporteve përcjellëse;
- Merr përgjegjësi dhe drejton punën si Drejtor i njësisë në marrëdhëniet me Komitetin e Auditimit, auditorët e jashtëm, dhe organet e tjera mbikëqyrëse;
- Zbaton kodin e etikës për auditorin e brendshëm, standardet ndërkombëtare dhe praktikat profesionale për auditim të brendshëm të Institutit të Auditorëve të Brendshëm.
- Ka qasje në të gjitha të dhënat e AKP-së, pa u kufizuar në ato të teknologjisë informatike, aseteve, evidencave financiare të cilat do të i mundësoj për të krijuar një opinion profesional lidhur me sistemin e Qeverisjes dhe të Kontrollit të Brendshëm të AKP-së

Sistemet dhe Procedurat

- Udhëheq dhe mbikëqyr shqyrtime të pavarura të sistemeve dhe procedurave ekzistuese apo të propozuara në të gjitha subjektet e AKP-së;
- Vlerëson efikasitetin dhe efektshmërinë e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm, monitoron performancën dhe propozon masa të nevojshme që ndikojnë në përmirësim;
- Vlerëson cilësitë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në aspektin e ekzistimit dhe mjaftueshmërisë të të themeluar nga menaxhmenti dhe në mënyrë aktive përfshihet në krijimin e një procesi raportues financiar të mjaftueshëm;
- Mbikëqyrë testimet e veprimeve të atyre sistemeve dhe seriozitetin dhe integritetin e informatave dhe transaksioneve të krijuara;
- Mbikëqyr dhe monitoron përputhjen me ligjet, politikat, procedurat, planet dhe rregulloret me të cilat qeveriset AKP-ja.

Trajnimet dhe Zhvillimet



- Planifikon trajnime, si Edukim i Vazhdueshëm Profesional për stafin e auditimit të brendshëm, në mënyrë që Njësia e Auditimit të Brendshëm të posedoj aftësi dhe zotësi kolektive për të audituar të gjitha aktivitetet e AKP-së
- Angazhon stafin e ri të caktuar në Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe i përgatit ata për të marr përsipër funksionet e auditimit të brendshëm.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohej, me të paktën 240 kredi/ ECTS apo ekuivalente me to sipas Rregullores së Qeverisë për Klasifikimin e Vendeve të Punës;
- Certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave;
 - Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale;

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Përvojë në auditimet e menaxhmentit (p.sh. auditimet operacionale, auditimet financiare dhe/apo auditimet e sistemeve informative) do të ishte një përparësi e veçantë;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve është përparësi;
- Njohuri të plotë të legjislacionit në fuqi, sidomos të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe rregullativës në fuqi;
- Aftësi udhëheqëse (leadership);
- Udhëheq, mbikëqyrë dhe udhëzon stafin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm si dhe menaxhon dhe vlerëson performancën e tyre;
 - Në bashkëpunim me DBNJ dhe Menaxhmentin e AKP-së, përkujdeset për zhvillimin dhe ngritjen profesionale të punonjësve të NJAB-së;



5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende
- Dëshmi që nuk është nën hetime

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 04/10/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Zyra Qendrore e AKP-se

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve të mëposhtme softuerike të pakos Microsoft;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës Shqipe ose gjuhës Serbe;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi shkruar;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

